



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT MONITORIMI

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës

Janar 2020

RAPORT MONITORIMI

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale

Përmbajtja

Përkufizimet.....	5
Hyrje	7
Baza ligjore	8
Ligji Nr. 04/l-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave	8
Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele ...	8
Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohet edhe mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe koha e transmetimit të programeve të tilla.....	8
Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.....	8
Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-Vizuele	9
Metodologjia.....	10
Gjetjet e identifikuar	12
OSHMA-të e gjetura në shkelje.....	14
Përfundim.....	15

Përkufizimet

KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.

DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së.

OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

OSH – Operatori i Shërndarjes nënkupton personin juridik i cili shpërndanë shërbime mediale audiovizuele për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv.

Termi “fëmijë” – nënkupton personat që i takojnë moshës deri në 14 vjeç.

Termi “i mitur” – nënkupton personat që i takojnë moshës prej 14 deri 18 vjeç.

Termi “kohë e kufizimit” – është koha në orarin radio/televiziv që ndan periudhën e lejueshme për të shfaqur program radio/televiziv, që ka përmbajtje për të rritur prej periudhës kur nuk është e lejueshme. “Koha e kufizimit” fillon prej orës 24:00 dhe mbaron në orën 05:00. Në shërbimet e parapagimit të cilat nuk janë të mbrojtura me kod, koha e kufizimit është po ashtu prej orës 24:00 deri në ora 05:00.

Termi “dhunë e panevojshme” – nënkupton përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike, mekanike apo çfarëdo force tjetër për të dëmtuar, lënduar apo keqtrajtuar.

Termi “frikë” – nënkupton emocionin, shpesh të fuqishëm, që nxitet nga parashikimi për rrezik, të keqe dhe dhimbje, pavarësisht se kërcënimi është real apo imagjinar.

Termi “përmbajtje erotike” – u referohet materialeve programore, që përqendrohen tek dëshira seksuale dhe që paraqesin zona të caktuara erogjene të trupit të njeriut dhe synimin final për akt seksual, por nuk i paraqesin personat në mënyrë të qartë gjatë marrëdhënieve seksuale.

Termi “programe me përmbajtje të dëmshme” – u referohet programeve, të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, dhe moral të fëmijëve, që në mes tjerash përfshijnë përmbajtjet me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përfituara nëpërmjet efekteve speciale, përmbajtjet me skena seksuale përfshirë skenat me shfaqje seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor dhe përmbajtja dhe programi me përmbajtje bixhozi, parashikimin e së ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.

Kategorizimi i programeve – në bazë të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, në bazë të përmbajtjes përcaktohen katër (4) kategori programore:

- **Kategoria e parë** përfshin programet që nuk kanë përmbajtje të dëmshme.
- **Kategoria e dytë** përfshin programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën dhjetë (10) vjeçare dhe për të cilat është e domosdoshme prania e prindit ose kujdestarit. Kjo kategori u referohet programeve, që përmbajnë ndonjë skenë dhune ose frike. Rastet kur bëhet portretizimi apo përshkrimi i dhunës dhe pasojave të saj mund të jenë të pranishme në përmbajtjen e programit nëse justifikohet nga objektivi i tij arsimor. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse.
- **Kategoria e tretë** përfshin programet që përmbajnë skena dhune dhe frike, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Përmbajtjet me skena seksuale mund të paraqiten në këtë kategori, përveç nëse paraqiten me qëllim të edukimit mbi seksualitetin dhe shëndetin e njeriut. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën katërmëdhjetë (14) vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë prania e prindit ose kujdestarit është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse.
- **Kategoria e katërt** përfshin programet që përmbajnë skena me përmbajtje të vazhdueshme dhune të panevojshme, frike, skena seksuale, përmbajtje pornografike, programe me përmbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht. Kjo kategori përfshin edhe përmbajtjet me skena të përdorimit të substancave narkotike, përdorimit të substancave të rrezikshme, përdorimit të armëve, produkteve të duhanit, produkteve të alkoolit, përmbajtjet ku paraqiten sjellje të rrezikshme, përmbajtjet ku përdoret gjuhë e papërshtatshme me kusht që në përmbajtjen e programit në tërësi këto nuk paraqiten si sjellje pozitive. Këto programe nuk rekomandohen për persona nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Transmetimi i programeve të kësaj kategorie duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse. Ndërsa, programet me përmbajtje pornografike mund të transmetohen vetëm në mënyrë të koduar.

Hyrje

Qëllimi i monitorimit të përmbajtjes programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Me fjalë tjera, qëllim i këtij raporti është përshkrimi i shkeljeve të identifikuara nga monitorimi i OSHMA-ve, e që përmes këtij përshkrimi dhe rekomandimeve të këtij raporti të ndërmerren masa nga ana e OSHMA-ve për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe evitimin e ekspozimit të tyre nga përmbajtjet e tilla programore.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë këtu edhe aspektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Lidhur me këtë, është realizuar monitorimi i OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes OSH-ve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Komisioni i Pavarur i Mediave në mënyrë të vazhdueshme ka treguar vëmendje të posaçme sa i përket zbatimit të akteve nënligjore të KPM-së nga ana e OSHMA-ve, me qëllim të mbrojtjes së kësaj kategorie të ndjeshme të shoqërisë nga përmbajtjet që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral.

Prandaj, krahas vlerësimit të zbatueshmërisë së akteve nënligjore të KPM-së, përmes këtij projekti monitorues synohet të krijohet një pasqyrë e qartë e raportit të fëmijëve dhe të miturve me përmbajtjet mediale audio-vizuale, respektivisht mbrojtjes së tyre nga përmbajtjet e dëmshme dhe të papërshtatshme.

Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në¹ dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu:

- KPM 2013/01 Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale²;
- KKPM-2016/03 Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës³;
- KPM 2017/07 Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale⁴.

Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale në Ligjin për KPM-në përcaktohen në nene të caktuara të këtij ligji që kanë të bëjnë me:

- Përmbajtjen e Komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet e reklamuar (sipas nenit 27);
- Sponsorizimin e programeve për fëmijë (sipas nenit 31);
- Vendosjen e produkteve (sipas nenit 32);
- Masat e duhura për të siguruar mbrojtjen në përgjithësi të fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme (sipas nenit 33).

Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale

Kjo rregullore në tërësi i është dedikuar mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral, përfshirë edhe mbrojtjen e identitetit dhe respektimin e dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohet edhe mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe koha e transmetimit të programeve të tilla.

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale në Kodin e Etikës përfshijnë çështjet lidhur me:

¹ <http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1335165851.7107.pdf>

² <http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1370439037.589.pdf>

³ <http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>

⁴ <http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1514284325.0124.pdf>

- Gjuhën e përdorur në përmbajtje programore (sipas nenit 4);
- Praninë dhe prezencën e fëmijëve në përmbajtjet programore në përgjithësi, përfshirë këtu çështjet e privatësisë, intervistat me fëmijë, etj. (sipas nenit 9).

Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-Vizuele

Dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele në Rregulloren për KKAV kanë të bëjnë kryesisht me:

- Përmbajtjen e komunikimeve komerciale audiovizuele, produktet dhe shërbimet e reklamuar, si dhe ndikimit të tyre tek fëmijët dhe të miturit (sipas nenit 9 dhe nenit 16);
- Orarin e transmetimit të KKAV-ve dhe teleshopingut për produkte të caktuara (sipas nenit 10);
- Mënryat e reklamimit (sipas nenit 12) dhe format e reklamimit si sponsorizimi i programeve për fëmijë (sipas nenit 14) dhe vendosja e produkteve (sipas nenit 15);
- Obligimet që kanë të bëjnë me Ofruesit e Shërbimeve Mediale Radio (sipas nenit 24 dhe 25).

Metodologjia

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHMA-ve me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, është bërë mbledhja e të dhënave, përkatësisht incizimi i përmbajtjeve programore të transmetuara, përmes sistemit të monitorimit⁵, i cili ka mundësuar ruajtjen e përmbajtjeve programore të subjekteve të këtij monitorimi.

Përmes këtij sistemi, është bërë analizimi dhe vlerësimi i përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë periudhës monitoruese.

Materialet referente bazë në dispozicion kanë qenë legjislacioni i Komisionit të Pavarur të Mediave, repektivisht rregulloret: KPM 2013/01 Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, KKPM-2016/03 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe KPM 2017/07 Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale. Këto rregullore janë zgjedhur për arsye se përbrenda vetes përmbajnë rregulla dhe obligime të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio vizuale.

Vlerësimi dhe analizimi është fokusuar në identifikimin e programeve me përmbajtje të dëmshme, që sipas akteve nënligjore në mes tjerash i referohen programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, dhe moral të fëmijëve, e që përfshijnë përmbajtje me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përfituara nëpërmjet efekteve speciale, përmbajtjet me skena seksuale përfshirë skenat me shfaqje seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor dhe përmbajtja dhe programi me përmbajtje bixhozi, parashikimin e së ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.

Vlerësimi është bërë edhe sa i përket kohës së transmetimit të përmbajtjeve të tilla programore, paralajmërimit dhe përdorimit të shenjave përkatëse të përcaktuara në Rregullore.

Po ashtu, vlerësimi dhe analizimi është bërë edhe në rastet kur fëmijët apo të miturit kanë qenë të përfshirë apo prezentë në përmbajtje të caktuara programore.

Vlerësimi i përmbajtjeve programore është bërë nga zyrtarët monitorues të Departamentit të Monitorimit dhe Analizave, të cilët kanë vlerësuar dhe analizuar çdo përmbajtje programore për periudhën kohore tetë (8) ditore, gjatë periudhës tetor – nëntor 2019. Periudha e monitorimit

⁵ Sistemi i monitorimit i dizajnuar për nevojat e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës të KPM-së, për incizim dhe monitorim të përmbajtjeve programore të të licencuarve të KPM-së, në formë audio dhe audiovizuale.

është zgjedhur në mënyrë rastësore, që ka përfshirë datat: 21, 23, 26, 27 tetor 2019 dhe 04, 06, 09, 10 nëntor 2019.

Mostra e monitorimit ka përfshirë pesëmbëdhjetë (15) OSHMA me status të ndryshëm të licencës dhe me përmbajtje programore gjeneralistike:

Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional:

1. RTK 1
2. KTV
3. RTV 21

Tetë (8) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional:

1. TV Besa
2. TV Dukagjini
3. TV Mitrovica
4. TV Most
5. TV Opinion
6. TV Prizreni
7. TV Puls
8. TV Vali

Katër (4) OSHMA-të që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes

1. RTK2
2. Klan Kosova
3. Rrokum TV
4. TE7.

Gjetjet e identifikuara

Në bazë të monitorimit, është vërejtur se OSHMA-të gjatë periudhës monitoruese kanë vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele, ndërsa shkelje janë vërejtur sa i përket Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM-2013/01.

Në bazë të monitorimit, në shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM-2013/01 janë gjetur gjashtë (6) OSHMA, prej tyre katër (4) me transmetim tokësor lokal/regjional dhe dy (2) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes:

1. RTK2
2. Rrokum TV
3. TV Opinion
4. TV Prizreni
5. TV Puls
6. TV Vali.

Shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë monitorimit kishin të bëjnë kryesisht me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale si: mos paralajmërimi me sinjal akustik apo tekstual para fillimit dhe pas ndërprerjeve të programeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, transmetimi i programeve të kategorive të caktuara jashtë kohës së paraparë sipas rregullores si dhe mos përdorimi i simboleve përkatëse vizuale.

Këto shkelje kanë të bëjnë me dispozitat si në vijim:

Neni 3, paragrafi 1:

“Shërbyesit medial audio-vizuel nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.”

Neni 3, paragrafi 3:

“Shërbyesit medial audio-vizuel të cilat transmetojnë radio/TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve të përcaktuar me këtë rregullore”.

Neni 4, paragrafi 1:

“Duhet t’i kushtohet kujdes i duhur dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve të cilët janë pjesë ose janë të përfshirë në programe. Kjo rregull duhet të zbatohet pavarësisht nga cdo pajtim që jepet nga prindi, kujdestari ose ndonjë person tjetër mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeçare i cili e përfaqëson të miturin”.

Neni 6, paragrafi 2:

Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 15:00 deri në ora 06:00.

Neni 6, paragrafi 3:

Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00”.

Neni 7, paragrafi 3, nënparagrafët 3.1 dhe 3.2:

“3. Para fillimit të programit dhe pas çdo ndërprerjeje të programit bëhet paralajmërim verbal dhe akustik”.

“3.1 Para fillimit të programit në TV shfaqet shenja paralajmëruese, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën ¼ e pjesës së dukshme të ekranit. Formulimi i vërejtjes së shkruar/tekstuale do të jetë: “Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë dhe të mitur”.

“3.2 Gjatë programit televiziv shfaqet vetëm pjesa vizuale e shenjës në këndin e ekranit, me dimensione minimumi 1/48 dhe maksimumi 1/32”.

OSHMA-të e gjetura në shkelje

TV Opinion - Në periudhën monitoruese, është identifikuar transmetimi i një seriali të huaj televiziv, i cili përshkruan zgjidhjen e rasteve të krimeve nga organet e rendit, që përfshijnë vrasje, plaçkitje, kidnapime etj.. Ky program përmban skena të papërshtatshme për fëmijë dhe të mitur. Transmetimi i këtij programi është bërë pa paralajmërim për përmbajtjen e tij, nuk është shoqëruar me shenjë përkatëse dhe është transmetuar jashtë kohës së paraparë në bazë të përkufizimeve të përcaktuara në Rregullore, përkatësisht nenit 3, paragrafi 1 dhe 3.

TV Prizreni - Në bazë të monitorimit, është vërejtur se në këtë OSHMA janë transmetuar filma të huaj artistik me përmbajtje të dëmshme, përfshirë skena dhune, frike dhe përmbajtje erotike të cilat nuk janë paralajmëruar për përmbajtjet e tyre, nuk janë shoqëruar me shenjat përkatëse si dhe janë transmetuar jashtë kohës së paraparë në Rregullore, përkatësisht nenit 3, paragrafi 3.

TV Puls - Në këtë OSHMA, gjatë periudhës monitoruese, shkelje janë gjetur gjatë transmetimit jashtë kohës së paraparë sipas nenit 6, paragrafi 2 të serialeve të kategorisë së dytë (10+) dhe gjatë transmetimit jashtë kohës së paraparë sipas nenit 6, paragrafi 3 të serialeve dhe filmave artistik të kategorisë së tretë (14+). Po ashtu, janë vërejtur shkelje gjatë transmetimit të disa serialeve dhe filmave të huaj artistik, të cilat nuk janë paralajmëruar tekstualisht në fillim të programit për përmbajtjen e tyre, si dhe nuk janë përdorur shenjat përkatëse vizuale gjatë kohëzgjatjes së tyre, siç përcaktohet sipas nenit 7, paragrafi 3 dhe nënparagrafi 3.1 dhe 3.2.

TV Vali - Gjatë periudhës monitoruese, në këtë OSHMA shkelje të nenit 3, paragrafi 3, janë gjetur gjatë transmetimit të filmave të huaj artistik me përmbajtje të dëmshme programore, përfshirë skena dhune, frike, përmbajtje erotike, të cilat nuk janë paralajmëruar para fillimit të tyre si dhe nuk janë identifikuar me simbolin përkatës gjatë kohëzgjatjes së tyre si dhe në një rast është vërejtur transmetimi një filmi artistik, me përmbajtje të dëmshme, jashtë kohës së paraparë në Rregullore.

RTK2 - Në bazë të monitorimit, shkelje e nenit 4, paragrafi 1, është vërejtur në një emision që i kushtohet komuniteteve në Kosovë dhe trajton gjendjen e vështirë të jetesës së këtyre komuniteteve. Në emision nuk i është kushtuar kujdes i duhur mbrojtjes së identitetit të fëmijëve prezentë ose të përfshirë në program, me ç'rast janë transmetuar imazhe/pamje të tyre në program.

Rrokum TV - Në periudhën monitoruese, në këtë OSHMA janë transmetuar filma të huaj artistik të cilët nuk janë paralajmëruar në fillim të transmetimit të tyre si dhe nuk janë kategorizuar bazuar në përmbajtjen e tyre, përkatësisht nuk janë shoqëruar me shenjat përkatëse të përcaktuara sipas nenit 3, paragrafi 1.

Përfundim

Nga të dhënat dhe rezultatet e monitorimit është gjetur se OSHMA-të vazhdojnë të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, kryesisht sa i përket mënyrës së paralajmërimit të programeve me përmbajtje të dëmshme, kategorizimit të përmbajtjeve programore të caktuara, kohës së transmetimit të tyre si dhe përdorimit të shenjave përkatëse për kategori të caktuara programore.

KPM rekomandon që të licencuarit e saj:

- Të veprojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në kuptimin e respektimit dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore;
- T'i kushtojnë rëndësi mbrojtjes së identitetit dhe respektimit të dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në programet ku ata janë prezent apo të përfshirë, veçanërisht gjatë trajtimit të temave të ndjeshme sociale;
- Të implementojnë standardet vetërregulluese të Kodit Praktik në pajtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM-2013/01; dhe
- T'i kushtojnë rëndësi mënyrës së kategorizimit të programeve me përmbajtje të dëmshme, kohës së transmetimit të tyre si dhe përdorimit të shenjave dhe piktogramave të përcaktuara me Rregullore.

KPM mbetet e përkushtuar që të zhvillojë politikat e transmetimit që kanë të bëjnë me masat parandaluese të identifikimit të duhur dhe evitimit të programeve me përmbajtje të dëmshme programore, përfshirë edhe rishikimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me këtë fushë. Në pajtim me mandatin ligjor, KPM do të sigurojë që OSHMA-të të trajtojnë me seriozitet rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral.

Raporti është përpiluar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave, në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të KPM-së z.Luan Latifi.

Në raport kontribuan:

Mirand Tafarshiku
Gentiana Hoti
Amela Redzovic
Sanije Imeraj Zatriqi
Luljeta Islamaj
Ardiana Sejdiu Musmurati
Sebahate Hajredinaj
Fikrete Çoçaj
Bashkim Reçica

Publikues:

Komisioni i Pavarur i Mediave
rr. Perandori Justinian Nr. 124

10000 Prishtinë

Kosovë

www.kpm-ks.org

Janar 2020